




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.P.SH. "ISP - BROADCAST"  
Nr. i biznesit - 70709465  
Pronar – z. Qëndrim KRYEZIU  
Rr/Rilindja Kombëtare, p.n.  
Malishevë

ISP BROADCAST" SH.P.K  
Numri unik identifikues - 810011643  
Pronar – z. Qëndrim KRYEZIU  
Rr/24 Maji Nr.46-1  
Prishtinë

Ref:1904/548/LIC/ni

### VENDIM

*për transferimin e licencës së Operatorit të Shpërndarjes ISP Broadcast nga biznesi N.P.SH.  
"ISP BROADCAST" në biznesin ISP BROADCAST SH.P.K.*

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. ISP Broadcast është Operatorë i Shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), për shpërndarjen e programeve radio televizive përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregullorën për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio (Rregullorja KPM-2016/01) ISP Broadcast është pajisur me licencë të KPM-së më datën 30 tetor 2013.
3. Më datën 12 prill pronari i Operatorit ISP Broadcast, ka parashtuar një kërkesë në zyrën e KPM-së, me antë të së cilës ka kërkuar transferimin e licencës së operatorit të shpërndarjes ISP Broadcasty nga biznesi individual N.P.SH. "ISP - Broadcast" me numër të biznesit 70709465, në biznesin si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ISP Broadcast SH.P.K. me numër unik identifikues 810011643, ku pronar i dy bizneseve është z. Qendrim Kryeziu.

#### Arsyetimi

4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së*".

5. Komisioni konstaton se, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar dokumentet dhe informacionet e nevojshme lidhur me kërkesën për bartjen e licencës. Dokumentet dhe informacionet dëshmojnë se dy bizneset, në mes të cilave kërkohet të bëhet bartja e licencës së ISP Broadcat, nuk kanë borxhe ndaj shtetit si dhe nuk kanë konteste të hapura gjyqësore.
6. Komisioni konstaton se, operatori i shpërndarjes ISP Broadcast nuk ka obligime financiare të pashlyera ndaj tarifës vjetore të licencës së KPM-së apo obligime financiare nga gjobat si dhe ka kryer pagesen e administrative për ndryshime në licencë e parapare me rregulloren KPM-2017/06.
7. Komisioni e konstaton se kërkesa është parashtruar konform Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM dhe si e tillë kërkesa për bartjen e licencës i plotëson kushtet për miratim.

### VENDIM

8. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 26 prill 2019, merr vendim për miratimin e kërkesës për bartjen e licencës së Operatorit të Shpërndarjes ISP Broadcast, nga biznesi individual N.P.SH. "ISP - Broadcat" me numër të biznesit 70709465, në biznesin Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ISP Broadcast SH.P.K. me numër unik identifikues 810011643, ku pronar i dy bizneseve është z. Qëndrim Kryeziu dhe licenca e KPM-së për këtë operatorë të ndryshohet.
9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Muja FERATI  
Kryetar  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



06.01.2019  
datë